



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK
PROGRAMI-E DREJTA PENALE
STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

**TEZA: “Ekzekutimi i dënimit me burg në Republikën e
Maqedonisë së Veriut, me theks të veçantë në Burgun e
Idrizovës për periudhën 2015-2020”**

Kandidati
Alije Ibrahim Xhelili

Mentor
Doc. Dr. Vedije Ratkoceri

Prill, 2021

Përmbajtja

Hyrje	6
KAPITULLI I	7
1. Historiku i dënimit me burg.....	7
1.1 Paraqitja e dënimeve me burgim dhe burgjet e para	7
1.2 Faktorët që ndikuan në paraqitjen e dënimit me burg.....	8
1.3 Sistemet për ekzekutimin e dënimit me burg.....	9
KAPITULLI II	13
2. Rregullimi i ekzekutimit të sanksioneve	13
2.1 Mënyra e rregullimit ligjor të ekzekutimit të sanksioneve	13
2.2 Të drejtat e të dënuarve.....	16
KAPITULLI III.....	18
3.1 Ekzekutimi i dënimit me burg.....	18
3.2 Entet ndëshkuese – korrektuese në Republikën e Maqedonisë së	18
3.2.1 Enti ndëshkues – korrektues – Idrizovë – Shkup	19
3.3 Parimet themelore	22
3.3.1 Parimi i risocializmit.....	22
3.3.2 Parimi i mbrojtjes.....	23
3.3.3 Parimi i sistemimit	24
3.3.4 Parimi i sigurimit të kushteve të duhura gjatë dënimit me burg	26
3.3.5 Parimi i punës në burg	29
KAPITULLI IV	34
4.1 Studim hulumtues lidhur me sanksionin penal dënim me burg në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga periudha 2015 – 2020.....	34
4.2 Të dhëna për vitin 2015	35
4.3 Të dhëna për vitin 2016	40
4.4 Të dhëna për vitin 2017	44
4.5 Të dhëna për vitin 2018	48
4.6 Të dhëna për vitin 2019	52
Përfundim dhe rekomandime.....	Error! Bookmark not defined.
Bibliografia	62

Abstrakt

Në shoqëri çdokush duhet të sillet me kujdesin e duhur, duke pasur parasysh që me veprimet e tij ose saj të mos e demtoj dikë tjetër. Në konceptin aktual, ne po flasim për ata subjekte ose persona të cilët me veprimet e tyre çënojnë vlera shumë të mëdha të personave të tjerë që më pas rezulton që të njejtës duhet të dënohen për veprimet e tyre. Në bazë të kësaj e kuptojmë qartë se liria që i është dhënë secilit, subjektët janë përgjegjës për lirinë e tyre, veprimet e tyre dhe se kjo nuk duhet që të shkon në dëm të dikujt tjetër. Me këtë nënkuptohet se askush nuk mundet që me lirinë e tij të keqpërdor duke çënuar ose asgjësuar ndonjë të drejtë të caktuar subjektit tjetër. Liria është një element me të cilën nënkuptohet që secili person është përgjegjës për veprimet e tij dhe se këto veprime duhet të jenë me kujdesin e duhur ndaj të drejtave të subjekteve të tjerë.

Mund të themi që sot problem kryesor është ballafaqimi me krimin. Krimi paraqitet si një element destruktiv që pengon zhvillimin e shoqërisë dhe shkakton pasoja të mëdha të personat që janë viktimë e tij. Krimi është problem shumë i madhë ku sot tentohet me të madhe të bëhet parandalimi dhe pengimi i tij por së fundmi edhe sanksionimi i atyre që e shkaktojnë krimin.

Në kuadër të kësaj themi që krimi duhet luftuar me qëllim të parandalimit ose zvogëlimit të së njejtës dhe kryerësit e krimit dhe veprave penale duhet të dënohen. Dënimet mund të jenë të ndryshme, por padyshim që ato prap se prap janë dënime të cilat duhet të zbatohen dhe njëkohësisht nënkuptohet zbatim i sanksionit subjekteve të cilët kanë kryer krimin. Kryerja e veprës penale vjen atëher kur nuk respektohet norma juridike, më saktë thënë nuk respektohet dispozicioni i normës juridike dhe nga kjo rezulton me shqiptim të sanksionit të normës juridike.

Njëra ndër format më të vështira të ekzekutimit të një sanksioni që vjen si pasojë e kryerjes së veprës penale është dënimi me burg. Ky dënim reflekton që kryerësit të krimit I merret e drejta substanciale njerëzore pas të drejtës së jetës e që është e drejta e lirisë. Por, kjo e drejtë mirret nga shkak që subjekti nuk është sjell konform rregullave por që i njejtës ka çënuar rregullat dhe si rezultat i kësaj ka marr sanksionin e caktuar e që në këtë rast flasim për dënimin me burg.

Апстракт

Во општеството, секој треба да се однесува со должно внимание, имајќи предвид дека неговите или нејзините постапки не му штетат на некој друг. Во сегашниот концепт станува збор за субјектите или лицата кои со своите постапки кршат многу високи вредности на други лица што потоа се покажува дека истите треба да бидат казнети за своите постапки. Врз основа на ова, јасно разбираме дека слободата што им се дава на сите, субјектите се одговорни за нивната слобода, за своите постапки и дека тоа не треба да оди на штета на некој друг. Ова значи дека никој не може да ја злоупотреби својата слобода со кршење или уништување на некое посебно право на друг субјект. Слободата е елемент што подразбира дека секоја личност е одговорна за своите постапки и дека овие постапки мора да бидат со должно внимание на правата на другите субјекти.

Можеме да кажеме дека главниот проблем денес е справување со криминал. Криминалот е претставен како деструктивен елемент што го попречува развојот на општеството и предизвикува големи последици врз лицата кои се негови жртви. Криминалот е многу голем проблем каде денес има поголем обид да се спречи и одврати, но неодамна се санкционираат и оние кои предизвикуваат криминал.

Во овој контекст, ние велиме дека кривичното дело мора да се бори за да се спречи или намали, а сторителите на кривично дело и кривични дела мора да бидат казнети. Казните може да бидат различни, но очигледно тие сепак се казни што мора да се применат и истовремено значи примена на санкцијата за субјектите кои го сториле делото. Сторувањето на кривично дело се случува кога не се почитува правната норма, поточно не се почитува одредбата на правната норма и тоа резултира со изрекување на санкција на правната норма.

Еден од најтешките форми на извршување на санкција што доаѓа како резултат на извршување на кривично дело е затвор. Оваа реченица одразува дека насилникот е лишен од суштинското човеково право по правото на живот, што е право на слобода. Но, ова право е земено од причината што субјектот не се однесувал во согласност со правилата, туку дека ги прекршил правилата и како резултат добил одредена санкција и во овој случај станува збор за затворска казна.

Abstract

In society, everyone should behave with due care, given that his or her actions do not harm anyone else. In the current concept we are talking about the subjects or persons whose actions violate very high values of other persons which then turns out that the same should be punished for their actions. Based on this we clearly understand that the freedom that is given to everyone, the subjects are responsible for their freedom, their actions and that this should not go to the detriment of someone else. This means that no one can abuse his freedom by violating or destroying any particular right of another subject. Freedom is an element which implies that each person is responsible for his actions and that these actions must be with due care to the rights of other subjects.

We can say that the main problem today is dealing with crime. Crime is presented as a destructive element that hinders the development of society and causes great consequences to the persons who are its victims. Crime is a very big problem here today there is a greater attempt to prevent and deter it, but recently also the sanctioning of those who cause crime.

In this context we say that crime must be fought in order to prevent or reduce it and the perpetrators of crime and criminal offenses must be punished. The punishments may be different, but obviously they are still punishments that must be applied and at the same time it means the application of the sanction to the subjects who have committed the crime. The commission of a criminal offense occurs when the legal norm is not respected, more precisely, the provision of the legal norm is not respected and this results in the imposition of a sanction of the legal norm.

One of the most difficult forms of execution of a sanction that comes as a result of committing a criminal offense is imprisonment. This sentence reflects that the perpetrator is deprived of the substantial human right after the right to life, which is the right to liberty. But, this right is taken from the reason that the subject has not behaved in accordance with the rules but that he has violated the rules and as a result has received a certain sanction and in this case we are talking about imprisonment.

Hyrje

Sjelljet dhe veprimet e njerëzve duhet të jenë konform normave me të cilat përcaktohen këto sjellje. Me këtë nënkuptohet që askush nuk ka të drejtë askujt t'i cënoj ndonjë të drejtë të caktuar. Të drejtat janë kategori të cilat duhet të respektohen dhe si të tilla të gëzojnë mbrojtje juridike.

Në këtë tezë do të flasim për historikun e dënimit si një masë ndaj subjekteve të cilët kanë shkaktuar ose kanë kryer veprë penale dhe se cili ka qenë dhe cili është qëllimi i asaj mase të caktuar që i'u është shqiptuar kryerësit të veprës penale dhe se cili është qëllimi që dëshirohet të arrihet me atë masë.

Më pas kemi sqarime lidhur me të drejtën aktuale se si ligji e rregullon mënyrën e ekzekutimit apo shqiptimit të dënimit ku në theks më të madhë do të flasim për dënimin me burg, si njëra ndër format më specifike për ekzekutimin e dënimit ndaj kryerësit të veprës penale dhe cila është qëllimi i dënimit me burg duke u bazuar në të drejtën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më pas do të flasim se cilat janë parimet themelore mbi të cilat sëndertohet ekzekutimi i dënimit me burg dhe se në cilën mënyrë duhet subjektët e caktuar të cilët janë më detyrë në institucionin ku shqiptohet dënimi të sillen me të burgosurit.

Në fund kam paraqitur një studim hulumtues me të cilën me shifra konkrete dhe në mënyrë decide japin një pasqyrim të numrit të personave të burgosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut në theks Burgun e Idrizovës. Këtë e kam paraqitur për një periudhë kohore prej vitit 2015 deri në vitin 2020. Në kuadër të kësaj kam paraqitur të dhëna lidhur me kryerësit të llojit që lidhen me: përkatësinë kombëtare të kryerësve të veprave penale, moshës së tyre, gjinisë së tyre dhe edukimit shkollor të tyre. Këto janë një pasqyrë evidente për të sqaruar rreth numrit të personave që gjenden në Burgun e Idrizovës si njëri ndër Burgjet më të rëndësishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI I

1. Historiku i dënimit me burg

1.1 Paraqitja e dënimeve me burgim dhe burgjet e para

Kur flasim për burgun, bëhet e qartë që kryerësit e veprave penale privohen nga liria dhe si pasojë e kësaj ata vendosen në burg. Dënimi me burg është njëri ndër dënimet më të hershme dhe që zënë një vend mjaftë të rëndësishëm në pjesën e të drejtës penale. Kur flasim për burgjet ka burime të ndryshme të cilat na paralajmërojnë se ku janë paraqitur dhe ne cilën formë kanë qenë të njejtat.¹

Fakti kur personi burgoset nënkuptohet kur një subjekt të gjitha aktivitetet e tija jetësore t'i kryen në një hapësirë mjaftë të kufizuar. Kjo hapësirë është hapësirë e tillë e cila është e rrethuar me të cilën sigurohet burgimi dhe mbikqyrje. Duhet cekur që burgu vjen në shprehje atëherë kur një subjekt sillet me një sjellje e cila është vepër penale.²

Ajo e cila është e rëndësishme është fakti se për parandalimin dhe zbulimin e krimit në secilën shoqëri merren masa të numërta të cilët varen me vlerat shoqërore dhe politike të shoqërisë konkrete.³

Më herët burgjet e ndryshme kanë qenë të vendosura në kështjella të vjetra të ashtuquajtura “Bastilles”, ose në bodrumet e kalave “Qubliettes”, të cilat kanë qenë të braktisura në atë kohë dhe kur flasim për kushtet të cilat kanë qenë aty mund të presupozojmë që kanë qenë mjaftë të vështira dhe jo komode që personat e dënuar të kalojnë dënimin me burg.⁴

Në njërën ndër shtetet më të lashtë, në Romën e vjetër, ka qenë burgu i njohur me emrin “Tullanium” ku janë mbajtur personat të cilët kanë qenë të dyshimtë deri në momentin kur është shqiptuar dënimi kryesor për të njejtat. Kjo ka qenë e rëndësishme për shkak që me këtë është bërë siguri i kryerësit derisa është mbajtur gjykimi dhe pengimi që ai të ik para se të shqiptohej ose të ekzekutohej dënimi.⁵

Si një institucion i parë i kësaj forme është konsideruar burgu “Bridvell” në Londër i cili u themelua në vitin 1553 nga ana e mbretit Eduard VI. Më pas forma të këtilla hasen edhe në

¹ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 93

² Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 81, 82

³ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенологија, Второ дополнето и изменето издание, Скопје, 2005, fq. 7

⁴ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 93

⁵ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 93, 94

Holandë ku formohen institucione të tilla që është njohur institucioni i burgut të “Amsterdami” më 1595. Aty janë vendosur endacakët lypës, bredhësit dhe prostitutat. Idea se pse këto janë vendosur në këtë institucion ka qenë që ata të angazhoheshin dhe të merreshin me punë konkrete e cila do t’i mundësonte atyre që të angazhohen me gjëra pozitive dhe të mund të lëjnë gjërat e këqija të cilat rrjedhin nga rruga.⁶

Burgjet të këtilla janë paraqitur edhe në disa vende të tjera dhe atë burgu i Bremenit më 1609, burgu i Libekut më 1613, burgu i Hamburgut në vitin 1622 në Gjermani si dhe më pas është paraqitur edhe burgu i Vjenës në vitin 1670.⁷

Në momentin që flasim për paraqitjen dhe për pjesën e zhvillimit të dënimit me burg mund të vijmë në përfundim se unifikimi i këtyre dënimeve me qëllim që të vendoset vetëm një dënim i caktuar është një tendencë e penologjisë bashkëkohore.⁸

Nga kjo të cilën e qartësuam deri më tani kuptojmë diçka e cila është mjaftë e qartë dhe e rëndësishme se ka ekzistuar shumë më herët institucioni i burgut por që nuk e ka pasur në terësi ose në plotkuptimin e fjalës qëllimin që e ka sot por burgimi si një ndër format e privimit nga liria dhe mjet i mbrojtjes nga kriminaliteti ka pasur dy faza dhe atë fazën preventive dhe fazën e dënimit.⁹

1.2 Faktorët që ndikuan në paraqitjen e dënimit me burg

Duke u bazuar më lartë e pamë që në periudhat e mëhershme kohore dënimet kanë qenë të ndryshme dhe mjaftë të rënda, ka pasur nevoj që personat të cilët janë kryerës të veprave penale të dënohen në institucione të caktuara si pasojë e veprës së tyre jo të mirë të cilën ata e kanë bërë dhe nga kjo është nevojitur që të paraqiten faktorë të caktuar të cilët do të ndikonin që të paraqitet institucionin i burgut në plotkuptimin e fjalës dhe ato janë tre faktorët kryesor të cilët do t’i cekim si vijon:

- 1.) Mendimet dhe idetë humaniste dhe përparimtare të filozofëve dhe shkollave të ndryshme;
- 2.) Idetë dhe kontributi i Revolucionit francez dhe legjislacioni i tij penal dhe ndikimi i pranisë së lirive dhe të drejtave të qytetarëve;

⁶ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 95

⁷ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 95

⁸ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенологија, Второ дополнето и изменето издание, Скопје, 2005, fq. 210

⁹ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 95

3.) Shfrytëzimi i punës së personave të dënuar si fuqi e lirë punëtore ¹⁰

Në këtë pjese lidhur me faktorët të cilat kanë ndikuar në paraqitjen e dënimit me burg ka luajtur rol shumë të rëndësishëm Revolucioni frances borgjez i vitit 1789, që ka sjell në ndryshime të thella në raportet shoqërore duke përfshirë edhe këtë pjesë. Më pas rol të madhë ka pasur edhe lidhja mes prodhimtarisë dhe raportet shoqërore nga njëra anë dhe sistemi i dënimeve nga ana tjetër. Rëndësi tjetër të madhe në paraqitjene e dënimit me burg kanë pasur edhe idetë humaniste nga filozofët dhe jurist e caktuar, por që ky lloj dënimi, dënimi me burg është realizuar më shpejtë në kodifikimet penale Evropë në fillim të shekullit XIX. ¹¹

1.3 Sistemet për ekzekutimin e dënimit me burg

Me paraqitjen e dënimeve me burg ka qenë dhe është bër një hap shumë i madhë drejtë asaj që i themi humanizmi i reagimit të shoqërisë ndaj krimit por jo vetëm kjo por edhe ndaj personave të cilët janë të dënuar me burg. ¹²

Ajo e cila është e rëndësishme është fakti se gjatë zhvillimit historik të dënimit me burg ka dërguar deri në paraqitjen e më shumë sistemeve penitenciare, por një rëndësi të madhe ka pasur zhvillimi i penologjisë me të cilën u paraqit nevoja që të përcaktohen edhe karakteristikat kryesore, vendi dhe roli i tyre se si duhet që dënimi me burg të zbatohet në kohën bashkëkohore. ¹³

Kur flasim për mënyrën se si është bërë ekzekutimi i dënimit me burg ose si janë trajtuar personat të cilët kanë qenë të burgosur ka më shumë mendime nga ana e autorëve se ekzistojnë një numër i madhë sistemesh lidhur me ekzekutimin e dënimit me burg. Si sisteme të tilla konsiderohen:

- a) Sistemi i burgut kolektiv;**
- b) Sistemi i qelisë;**
- c) Sistemi i heshtjes;**
- d) Sistemi i pikave;**

¹⁰ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 96

¹¹ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 88, 89, 90

¹² Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 101

¹³ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенологија, Второ дополнето и изменето издание, Скопје, 2005, fq.161

e) Sistemi progresiv;

por, përveç këtyre sistemeve ka edhe të atilla të cilat mbështeten në idetë bashkëkohore ose moderne që lidhen me risocializmin ose riintegrimin e personave të dënuar e që janë:

a) Sistemi i klasifikimit;

b) Sistemi bashkëkohor modern. ¹⁴

Sistemi i burgut kolektiv është sistem i atillë me të cilën nuk ka klasifikime të personave të dënuar dhe sipas autorëve ky është sistem i parë i organizimit të ekzekutimit të dënimit me burg. Në këtë sistem nuk ka asnjë lloj klasifikimi dhe se të gjithë personat e dënuar në mënyrë të përbashkët e mbajnë dënimin qofshin ato kryerës të veprave ose krimeve të rënda, recidivistët, personat të cilët kanë një karrierë të gjatë kriminale, personat e mitur së bashku me personat e vjetër dhe ata të cilët janë kryerës primar me kryerësit sekondar. Si vende në të cilat janë mbajtur dënimet kanë qenë bodrumet ose lokalet e ndryshme të cilat kanë qenë të braktisura të fortesave, kështjellave, kalave ose objekteve të tjera ku mënyra e mbajtjes së dënimit me burg ka qenë shumë e rëndë. ¹⁵

Sistemi i izolimit është sistemi i parë i cili ka qenë i rregulluar në mënyrë normative juridike. Qëllimi i këtij sistemi ka qenë se ata kanë qenë kundër zbatimit të dënimeve me vdekje dhe torturave të ndryshme fizike por që personat të cilët kryejnë vepër penale të izoloreshin, ose që ata të jenë të vetmuar. Me këtë formë ka pasur për qëllim që këtyre personave t'i jepet mundësia që ata të pendohen për veprimet e tyre dhe që të mundet të përmirësohen. Në bazë të kësaj personat e dënuar është dashur që të vendoseshin nëpër qeli dhe të qëndrojnë për një kohë të caktuar dhe në këtë formë të pendohen për krimin të cilin ata e kanë bërë. ¹⁶

Sistemi i heshtjes ose i Obernit (Auburn-it) është një sistemi i tillë i cili për dallim nga sistemi i izolimit i ka mundësuar personave të dënuar, natën të qëndrojnë ndaras nga njëri tjetri dhe të izoloohen plotësisht, ndërsa gjatë ditës ata dërgoheshin në punë dhe aktivitete që aty u është dhënë mundësia që të dalin nga izolimi që të punojnë me personat e tjerë të dënuar. Por, fakti që ata kanë shkuar në punë së bashku atyre u është ndaluar që të bisedojnë dhe të komunikojnë njëri me tjetrin. Në momentin kur ky parim ka hasur në shkelje nga

¹⁴ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 101, 102

¹⁵ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 102

¹⁶ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 105

personat e dënuar atëherë ai person i cili shkel këtë parim do të dënoheshte në mënyrë më strikte të mundshme nga ana e personelit të institucionit. Për këtë arsye ky sistem e ka marrë edhe emrin sikur sistemi i heshtjes.¹⁷

Sistemi progresiv është një sistem i atillë që personit të dënuar i mundëson që ta ndëroj pozitën e tij në burg, që do të thotë që gjatë mbajtjes së dënimit, kalon nëpër disa faza në mënyrë progresive me të cilat e ndryshon pozitën e tij. Kjo nënkuptohet që dallon pozita në hyrje të burgut, pra izolim total, më pas kur vërehen shenja se ka ndryshuar në aspekt pozitiv ai kalon në burgun e përbashkët ose atë që i themi kolektiv. Në këtë pjesë ai kyçet në procesin e punës dhe në këtë mënyrë ai mund ta tregoj vetën e tij edhe më shumë. Në rast se edhe në këtë fazë ka shenja pozitive se personi është përmirësuar mjaftueshëm atëherë kalon me një etap tjetër e cila është mjaftë pozitive që mund të jetë lirimi me kusht ose qëndrimi në atë që është quajtur paralele për të lirë e më pas lirimi me kusht.¹⁸

Sistemi i pikëve është sistem i tillë i cili kalon në disa faza edhe atë: në fazën e parë të dënuarit kanë qenë të detyruar të punojnë, në fazën e dytë personave të dënuar i jepet mundësia që të ndahen në grupe pune dhe secilit i caktoheshte numri i poenave ose pikëve të cilat duhet t'i arrijnë, në fazën e tretë grupi i personave të dënuar shpërndahej dhe secili person i cili ka qenë i dënuar ka fituar nga një shtëpizë të vetën, më një hapësirë të caktuar të sipërfaqes së tokës ku ai ka mund që të merret me bujqësi dhe duke u marrë me kultivim të prodhimeve të ndryshme. Nga kjo kuptojmë që personat e dënuar duhet t'i përmbushnin një sasi të pikëve ose poenave të caktuar dhe detyrimeve të cilat ata i kanë pasur për të arritur lirin e tyre të plotë.¹⁹

Sistemi i klasifikimit është sistemi i cili është përpjekur që të bëjë klasifikimin e personave të dënuar në nëngrupe, klasë e paralele me të vetmin qëllimin e që është riedukimi dhe që të arrihet përmirësim i suksesshëm. Ky sistem ka tre faza kryesore dhe atë: fazën e qelisë ku personat kalojnë një kohë të mbajtjes së dënimit në qeli të izoluar, fazën e burgut të përbashkët ku personat e dënuar ndahen dhe klasifikohen në grupe, nëngrupe, klasa dhe paralele dhe fazën e daljes para kohe në liri që ka të bëjë me lirin me kusht të personave të dënuar të cilët me sukses i kanë kaluar sfidat e fazave të mëparshme dhe konsiderohet se ata

¹⁷ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 107, 108

¹⁸ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 109, 110

¹⁹ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 114, 115, 116, 117

janë përmirësuar dhe nuk ka rrezik që të bëjnë vepër penale të sërishme.²⁰

Sistemi modern ose bashkëkohor është sistem i atillë ku nuk është e pranishme faza e izolimit të personave të dënuar, por ama kjo nuk do të thotë që izolimi edhe në këtë sistem është humbur në tërësi nga shkak që edhe këtu izolimi aplikohet si një masë e caktuar disiplinore ndaj personave të dënuar të cilët nuk sillen në përputhje me rregullat ose rendin shtëpiak ose persona të atillë të cilët janë agresiv dhe të cilët me sjelljen e tyre ndikojnë negativisht te personat e tjerë të dënuar me të cilën i pamundësohet atyre që të mundet të riintegrohen në institucion. Ky sistem ndahen në tre faza kryesore të cilat e karakterizojnë të njëjtin dhe atë: faza e parë është fazë ku bëhet vërtetimi dhe studimi i personit i cili është i dënuar, pra në këtë fazë personi i cili është i dënuar i bëhet një analizë nga një ekip ekspertësh të lëmvive të ndryshme shkencore kjo nga shkak që të dihet më shumë për këtë person që më pas më lehtë të ketë procesin e risocializimit. Në fazën e dytë është një lloj kombinimi të klasifikimit të gjërë të personave të cilët janë të dënuar dhe faza e tretë është faza e lëshimit me kusht dhe ndihmës pas kryerjes së dënimit me burg ose më mirë thënë ndihmës postpenale që i jepet personit të dënuar.²¹

Risia në këtë sistem qëndron në faktin se ky është sistem modern ose bashkëkohore dhe se ndihma e caktuar e cila i jepet personit pasi që ta kryen dënimin me burg është diçka më specifike nga sistemet të cilat u përmendën më lartë nga shkak që personat e dënuar të cilët lëshohen me kusht u ofrohet një ndihmë e caktuar që lidhet me sigurimin e punës së tyre që do të thotë që ata të angazhohen me punë, që lidhet me sigurimin e vendosjes së tyre, mbrojtjen shëndetësore dhe ndihma të tjera të cilat kanë për qëllim që të ndihmojnë në stabilizimin e tyre dhe që të mundet që këta subjekt të cilët janë të liruar me kusht të pengohen për kryerje të sërishme të ndonjë vepre të caktuar penale.²²

Ajo e cila është e rëndësishme është fakti se duke u bazuar në të gjitha këto sisteme penitenciare të cilat kanë filluar në shekullin XX dhe deri në pjesën e sistemeve bashkëkohore të shqiptimit të dënimit me burg mund t'i ndajmë në këto kategori:

- a) Sistemi asociacial ose sistem i burgut kolektiv
- b) Sistemi i qelisë ose i vetëm
- c) Sistemi progresiv²³

²⁰ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 117, 118

²¹ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 119, 120, 121, 122

²² Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 119, 120, 121, 122

²³ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 97

KAPITULLI II

2. Rregullimi i ekzekutimit të sanksioneve

2.1 Mënyra e rregullimit ligjor të ekzekutimit të sanksioneve

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve është mekanizëm direkt i rregullimit të materies lidhur me ata subjekte të cilat shkelin dispozicionin e normës juridike dhe më pas shkaktohet sanksioni lidhur me normën juridike. Nga kjo kuptojmë që në kuadër të këtij ligji bëhet rregulli i ekzekutimit të sanksioneve të personave të cilët nuk sillen në përputhje me normën juridike penale dhe në momentin kur shkelet kjo normë juridike atëherë vërehet se sanksioni lidhur me këtë normë juridiko-penale. Më saktë thënë më këtë ligj në mënyrë të qartë dhe shumë strikte rregullohet ekzekutimi i sanksioneve të cilat shqiptohen për veprat penale të cilat kryhen si dhe për kundërvajtjet.²⁴

Ky është ligji i cili vjen në shprehje në ato raste kur gjykata sjell vendimin që subjekti i caktuar ka kryer ndonjë vepër penale ose kundërvajtje dhe më pas bëhet ekzekutimi i këtij vendimi të gjykatës. Në kuadër të ligjit për ekzekutimin e sanksioneve të cilat në mënyrë të saktë ndahen në disa lloje të sanksioneve të cilat kanë një rëndësi të madhe dhe ato janë:

- a) **Dënimet;**
- b) **Masat alternative ndaj fëmijëve;**
- c) **Masat e sigurisë;**
- d) **Masat edukative**²⁵

Në kuadër të kësaj e shohim që varësisht nga veprimi i subjektit dhe shkeljes së normës juridiko-penale më pas vendoset lidhur me këto dënime të cilat dallojnë nga njëra tjetra por që qëllimi është kryesor risocializimi i subjektit të cilit ka kryer ndonjë vepër penale më saktë thënë vepër e cila është e dënuar penalisht dhe kryerësi i asaj veprë të ndaluar të kupton gabimin e tij si dhe në të ardhmën të mos bën ndonjë gabim të njejtë apo të ngjajshëm. Pra, edhe pse ka dallime

²⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 1 paragrafi 1

²⁵ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 1, paragrafi 2

sa i përket veprimeve të subjektëve prap se prap këto veprime dhe këto dënime janë në harmoni për të arritur qëllimin që subjekti i cili ka kryer ndonjë veprim të këtillë të kuptojë që veprimi ka qenë i gabuar dhe që në të ardhmën mos të bën ndonjë veprim të tillë.

Ajo e cila është mjaftë e rëndësishme është fakti që mënyra e zbatimit të rregullave të cilat dalin apo rrjedhin nga ky ligj është se të njejtat zbatohen në mënyrë të paanshme, do të thotë zbatohen në mënyrë objektive.²⁶

Në këtë rast bëhet e qartë se ekzekutimi i sanksioneve bëhet në mënyrë objektive që nënkuptohet qartë se ndalohet çfarëdo lloj diskrimini i cili lidhet me:

- a) *Racën;*
- b) *Ngjyrës së lëkurës;*
- c) *Prejardhjes;*
- d) *Përkatësisë nacionale apo etnike;*
- e) *Gjinisë;*
- f) *Seksit;*
- g) *Orientimit seksual;*
- h) *Identitetit seksual;*
- i) *Përkatësisë në grup të marginalizuar;*
- j) *Gjuhës;*
- k) *Shtetësisë;*
- l) *Prejardhjes sociale;*
- m) *Arsimimit;*
- n) *Religjionit apo bindjes fetare;*
- o) *Bindjes politike;*
- p) *Bindjeve tjera;*
- q) *Pengesës;*
- r) *Moshës;*
- s) *Gjendjes familjare apo martesore;*
- t) *Gjendjes shëndetësore;*
- u) *Cilësisë personale dhe statusit shoqëror apo çfarëdo baze tjetër të personit ndaj të cilit ekzekutohet sanksioni.*

²⁶ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 4, paragrafi 1

Lidhur me këtë ndarje të madhe që lidhet shumë me elementin që fakti i ekzekutimit të sanksioneve bëhet duke mos marrë parasysh asnjë nga këto elemente, do të thotë qartë që ai i cili kryen veprën penale ose shkel normën juridiko-penale në këto raste nuk ka ndonjë rëndësi lidhur me këto elemente, por e rëndësishme se ai është kryerës i veprës penale dhe për të njejtën duhet të ekzekutohet sanksioni, pra duke mos bërë dallime të caktuara, të bazuara në grupimet të cilët i potencuam më lartë. Në pjesën e lartcekur në mënyrë decide në ligj potencohet që ndalohen të gjitha format e diskriminimit në të gjitha elementet dhe se ai i cili nuk është sjell në përputhje me normën juridiko-penale, ndaj tij më pas do të vjen sanksioni.²⁷

Duhet pasur parasysh që gjatë shqiptimit të sanksionit ndaj personave të cilët janë kryerës të veprave penale duhet doemos të respektohen ndjenjat fetare të tyre, bindja personale e tyre dhe normat morale, për shkak që bëhet fjalë për gjëra mjaftë të ndjeshme dhe të cilat në çdo rast duhet të respektohen madje edhe gjatë shqiptimit të sanksionit.²⁸

Nga ajo të cilën e potencuam më lartë sqaruam që ndalohet diskriminimi ndaj personave ndaj të cilëve bëhet ekzekutimi i sanksionit, por njëkohësisht ajo e cila është mjaftë e nevojshme që të potencohet gjë që në mënyrë strikte potencohet edhe në ligjin për ekzekutimin e sanksioneve është se kryerësi i veprës penale nuk duhet të trajtohet me trajtim jo njerëzor ose trajtim i cili do të kishte ndikim negativ tek ai, por idea dhe qëllimi i ekzekutimit të sanksionit është risocializimi dhe fakti që subjekti të kupton që veprimi i tij nuk ka qenë i duhur dhe se në të ardhmën nuk duhet të veproj në atë mënyrë.

Nga kjo mund të kuptojmë që në momentin kur bëhet ekzekutimi i sanksioneve duhet pasur shumë kujdes që të veprohet në mënyrë njerëzore, kjo do të thotë që ndaj atyre subjekteve duhet të ketë trajtim normal njerëzor, sepse kjo ka ndikim që ata ta kuptojnë edhe më mirë për shkeljen e normës juridiko-penale, më pas duhet të respektohet në nivel të lartë personaliteti dhe dinjteti njerëzor i atij personi, duhet të ketë një kujdes për ruajtjen e shëndetit të tyre fizik dhe shëndetit të tyre shpirtëror, ngase ky moment tek secili nga ata subjekte ka ndikime të ndryshme dhe se duhet pasur kujdes në këtë drejtim dhe se idea kryesore e ekzekutimit të sanksionit është që të mund të realizohet qëllimi i sanksionit e që është risocializimi dhe që ka një rëndësi mjaftë

²⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 4, paragrafi 2

²⁸ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 4, paragrafi 3

të madhe në rastin konkret.²⁹

Në këtë aspekt kur flasim për ekzekutimin e sanksioneve e kemi të qartë se këtu nevojitet një procedurë e caktuar e cila duhet të respektohet dhe se përcaktohet në mënyrë të qartë se si duhet të jetë, ndërsa sa i përket kësaj pjese duhet të dijmë që sanksionet i zbatojnë organet e përcaktuara me ligjin për ekzekutimin e sanksioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.³⁰

Kur flasim për ekzekutimin e sanksioneve ajo e cila është mjaftë e rëndësishme është fakti se kompetentë për punët që lidhen me ekzekutimin e sanksioneve është Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve.³¹

Ndërsa, me punët që lidhen për ekzekutimin e sanksioneve udhëheq drejtori i Drejtorisë, në fakt kjo është një përgjegjësi që të mund të zbatohen normat juridiko-penale dhe të respektohet procedura e caktuar e cila lidhet me ekzekutimin e sanksioneve.³²

2.2 Të drejtat e të dënuarve

Në këtë kapituj do të tentojmë të flasim sa i përket të drejtave të personave të dënuar për shkak se në bazë të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut më numërim të saktë dhe striktë potencohen se cilat janë të drejtat e personave të dënuar. Kjo është një gjë mjaftë e rëndësishme që në mënyrë të detajuar të njoftohemi se cilat janë ato të drejta të cilat personat e dënuar mund t'i shfrytëzojnë që njëkohësisht kanë rëndësi për qëndrimin e tyre, funksionimin e tyre dhe bëhet fjalë për të drejta të cilat janë mjaftë të nevojshme që konsiderohen si esenciale për personat e burgosur.

Ajo që është poashtu mjaftë e rëndësishme është fakti se secili person ndaj të cilit është shqiptuar ndonjë dënim ose secili person i cili është i dënuar ose fëmijë, të cilit është shqiptuar ndonjë masë e caktuar edukative institucionale Dërgim në shtëpin edukuese – përmirësuese, përderisa zgjat ekzekutimi i dënimit me burg ose ndonjë mase tjetër institucionale, në kuadër të ligjit parashihen të drejta të caktuara dhe atë janë këto të drejta:

²⁹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 6

³⁰ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 7, paragrafi 1

³¹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 8, paragrafi 1

³² ³² Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 8, paragrafi 2

- Të drejtën për akomodim;
- Të drejtën për veshje dhe mbulesa;
- Të drejtën për higjienë personale;
- Të drejtën për ushqim;
- Të drejtën për trajtim;
- Të drejtën për pushim;
- Të drejtën për sigurim pensional;
- Të drejtën për mbrojtje shëndetësore;
- Të drejtën për informim;
- Të drejtën për plotësimin e nevojave fetare;
- Të drejtë për kontakt me botën e jashtme (telefonata, vizita);
- Të drejtë për pranimin e dërgesave;
- Të drejtë për lidhjen e martesës;
- Të drejtën për ndihmë juridike;
- Të drejtë për azhurnimin e letërnjoftimit.³³

Këto janë të drejta të cilat rrjedhin prej ligjit për ekzekutimin e sanksioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.³⁴

³³ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 155

³⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 155

KAPITULLI III

3.1 Ekzekutimi i dënimit me burg

3.2 Entet ndëshkuese – korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një numër të konsiderueshëm të enteve ndëshkimore – korrektuese të në të cilat subjektet e caktuara e kalojnë pjesën e dënimit të tyre për veprat penale të cilat i kanë kryer dhe më pas mbajnë dënimin me burg. Në kuadër të kësaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka disa Ente ndëshkimore – korrektuese dhe ato janë:

- Enti ndëshkues – korrektuese - Idrizovë
- Enti ndëshkues – korrektues - Shkupit
- Enti ndëshkues – korrektues - Strugë
- Enti ndëshkues – korrektues - Gevgeli
- Enti ndëshkues – korrektues – Manastir
- Enti ndëshkues – korrektues – Prilep
- Enti ndëshkues – korrektues – Kriva Pallankë
- Enti ndëshkues – korrektues – Ohër
- Enti ndëshkues – korrektues – Tetovë
- Enti ndëshkues – korrektues – Shtip
- Enti ndëshkues – korrektues – Veles
- Enti ndëshkues – korrektues – Strumicë
- Enti edukativo – korrektues – Tetovë ³⁵

³⁵ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003

3.2.1 Enti ndëshkues – korrektues – Idrizovë – Shkup

Në këtë ent mbahen dënimet me burg dhe burgim të përjetshëm:

- a) Persona meshkuj recivistë, të dënuar me vendim gjyqësor me dënim me burg mbi 6 muaj, ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur me paraburgimin është mbi 6 muaj
- b) Persona meshkuj – primar të cilët me vendim gjyqësor janë dënuar mbi 2 vite, ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur me paraburgimin është mbi 2 muaj
- c) Femra të dënuar me vendim gjyqësor me dënim me burg duke mos e marrë parasysht lartësinë e dënimit
- d) Meshkuj dhe femra të dënuar me dënim me burgim të përjetshëm
- e) Shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi ³⁶

Në entin ndëshkues – korrektues – Idrizovë duhet të dihet që është ent i përgjithshëm ku mbahet dënimi me burg për shumë kategori të personave të dënuar dhe atë:

- a) Persona meshkuj dhe femra
- b) Të huaj
- c) Persona të dënuar për kundërvajtje

Në këtë ent ka klasa të llojit të mbyllura, të hapura dhe gjysmë të hapura. Poashtu në këtë ent është edhe enti edukativ – korrektues për persona të mitur të gjinisë femrore.

Për formimin e këtij enti dhe fillimin me punë të të njëjtit nuk egziston ndonjë dokumentacion. Presupozohet që enti ndëshkues – korrektues Idrizovë ka filluar me punë prej momentit kur është ndërtuar objekti kryesor në vitin 1908.

Enti ndëshkues – korrektues Idrizovë ka një objekte ku vendosen të dënuarit, por edhe ku punojnë personat e dënuar. Në entin ndëshkues – korrektues në Idrizovë ka klasa të llojit të mbyllur, gjysmë të hapura dhe të hapura, klasa e grave dhe objekti në të cilin është vendosur ambulanta dhe klasa e pleqëve. ³⁷

- **Enti ndëshkues – korrektues – Strugë** – në këtë ent mbahen mbahen personat:

- a) Persona meshkuj të dënuar për vepra penale sipas Kodit Penale të cilët dënohen me vendim për dënim me burg nga 2 deri në 5 vjet, ose pas përlllogaritjes së paraburgimit

³⁶ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 125

³⁷ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 168

- i ngelen 2 deri 5 vjet dënim me burg
- b) Persona meshkuj – primar me vendim me burg deri në 2 vite ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përllogaritur me paraburgimin është deri në 2 vite
 - c) Persona meshkuj dhe femra të dënuar për kundërvajtje në kompetencë të gjykatave themelore Dibër dhe Strugë³⁸
- **Enti ndëshkues – korrektues – Manastir** – në këtë ent paraqiten përfshihen personat për dënim me burg:
- a) Persona meshkuj – primar të dënuar me vendim për dënim me burg deri më 2 vite, ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përllogaritur edhe paraburgimi është deri në 2 vite për vendin që janë në kompetencë të gjykatave themelore Manastir, Kërçovë dhe Resnjë.
 - b) Persona meshkuj – recidivistë të dënuar me dënim me burg deri në 6 muaj ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përllogaritur edhe paraburgimi është deri në 6 muaj në kompetencë të gjykatave themelore Manastir, Kërçovë, Krushevë, Prilep dhe Resnjë
 - c) Persona meshkuj dhe femra ndaj të cilëve është përcaktuar paraburgim nga kompetenca e gjykatave themelore Manastir, Kërçovë, Prilep dhe Resnjë
 - d) Persona meshkuj dhe femra të dënuar për kundërvajtje në kompetencë të gjykatave themelore Manastir, Kërçovë dhe Resnjë.³⁹
- **Enti ndëshkues – korrektues Gjevgjeli** – në këtë ent përfshihen:
- a) Personat meshkuj – primar të dënuar me vendim në dënim deri më 2 vite ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përllogaritur edhe paraburgimi është deri në 2 vite në kompetencë të gjykatave themelore të Gjevgjelisë, Kavadarcit dhe Negotinës
 - b) Persona meshkuj – recidivistë të dënuar me vendim për dënim me burg deri në 6 muaj ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përllogaritur edhe paraburgimi është deri në 6 muaj në kompetencë të gjykatave themelore të Gjevgjelisë, Kavadarcit dhe Negotinës
 - c) Persona meshkuj dhe femra, të dënuar për kundërvajtje në kompetencë të gjykatave themelore të Gjevgjelisë, Kavadarcit dhe Negotinës

³⁸ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 173

³⁹ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 185

d) Persona meshkuj dhe femra ndaj të cilëve është vendos paraburgimi në kompetencë të gjykatave themelore të Gjevgjelisë, Kavadarcit, Negotinës

- **Enti ndëshkues – korrektues – Ohër – përfshihen personat:**

- a) Persona meshkuj – primar të dënuar me vendim gjyqësor me dënim me burg deri në 2 vite ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur paraburgimi është deri në 2 vite në kompetencë të gjykatës themelore Ohër
- b) Persona të ri të rritur dhe persona të mitur meshkuj të dënuar me dënim për burgim të të miturve
- c) Persona meshkuj recidivistë të dënuar me vendim për dënim me burg deri në 6 muaj ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur paraburgimi është deri në 6 muaj në kompetencë të gjykatave themelore Dibër, Ohër dhe Strugë.
- d) Persona meshkuj dhe femra për dënim për kundërvajtje në kompetencë të gjykatës themelore Ohër
- e) Persona meshkuj dhe femra të cilëve është vendosur paraburgim në kompetencë të gjykatave themelore Dibër, Ohër dhe Strugë.⁴⁰

- **Enti ndëshkues – korrektues Shkup – në këtë ent përfshihen personat:**

- a) Personat meshkuj – primar të dënuar me vendim për dënim me burg deri në 2 vite ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur paraburgimi është deri në 2 vite në kompetencë të gjykatave themelore Shkup I, Shkup II dhe Kumanovë
- b) Persona meshkuj recidivistë të dënuar me vendim për dënim me burg deri në 6 muaj ose pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur paraburgimi është deri në 6 muaj në kompetencë të gjykatave themelore Veles, Kratovë, Kriva Pallankë, Shkup I, Shkup II dhe Kumanovë
- c) Persona meshkuj dhe femra të dënuar për kundërvajtje në kompetencë të gjykatave themelore Shkupi I, Shkupi II dhe Kumanovë
- d) Persona meshkuj dhe femra që janë vendos në paraburgim në kompetencë të gjykatave themelore Veles, Kratovë, Kriva Pallankë, Kumanovë, Shkupi I, Shkupi II

⁴⁰ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 231

- **Enti ndëshkues – korrektues Tetovë** – në këtë ent përfshihen personat:
 - a) Persona meshkuj – primar të dënuar me vendim për dënim me burg deri në 2 vite, ose pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur paraburgimi është deri në 2 vite në kompetencë të gjykatave themelore Gostivar dhe Tetovë
 - b) Persona meshkuj – recidivistë të dënuar me vendim për dënim me burg deri në 6 muaj ose kur pjesa e ngelur e dënimit e përlllogaritur paraburgimi është deri në 6 muaj në kompetencë të gjykatave themelore Gostivar dhe Tetovë
 - c) Persona meshkuj dhe femra të cilat jënë të dënuar për kundërvajtje në kompetencë të gjykatave themelore Gostivar dhe Tetovë
 - d) Persona meshkuj dhe femra të cilët janë të vendosur në paraburgim në kompetencë të gjykatave themelore Gostivar dhe Tetovë ⁴²

3.3 Parimet themelore

3.3.1 Parimi i risocializimit

Në fakt, më lartë biseduam dhe sqaruam që ekzekutimi i sanksioneve nuk ka për qëllim hakmarrjen ndaj personit i cili ka kryer vepër penale, por qëllimi është risocializimi i tij, që me këtë sanksion ky subjekt të kuptoj që veprimi i tij nuk ka qenë veprim i duhur por që ka qenë veprimi i gabuar dhe që të mundet që gjatë dënimit të risocializohet, më saktë thënë të mund të përfshihet sërish në shoqëri që mos të bën ndonjë vepër të njejtë për të ardhmën. Nga kjo e kuptojmë që parimi i risocializimit në vetë përfshin një proces mjaftë të veçantë ngase kjo paraqitet si funksion themelor ose më i rëndësishëm i institucionit ndëshkues – përmirësues dhe institucionit edukativ – përmirësues. ⁴³

Nga kjo e kuptojmë qartë se parimi i risocializimit është në fakt qëllimi kryesor i ekzekutimit të sanksionit, ngase ky është një proces më i gjatë i cili ndikon te kryerësi që të kuptoj gabimin e tij dhe të mos e përsëris në të ardhmën një gjë të tillë, pra qëllimi kryesor se pse

⁴¹ Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 257

⁴² Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003, fq. 311

⁴³ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 14, paragrafi 1

bëhet ekzekutim i sanksionit të dënimit me burg, si njëra ndër format kryesore të shqiptimit apo ekzekutimit të sanksioneve është që këto persona të cilët dënohen me burg të mundet të aftësohen që të përfshihen në shoqëri sërish më mundësi të cilat janë më të mira për një jetë të pavarur. Pra, sanksioni ose dënimi me burg edhe pse në shikim të parë mund të reflektojë si një gjë e cila është hakmarrje ndaj kryerësit të veprës penale, kjo nuk ka të bëjë me këtë gjë, por ka të bëjë me faktin që ai të mundet të kuptoj gabimin të cilin e ka bërë dhe nga kjo të mundet sërish të përfshihet në shoqëri dhe më pas me faktin e përfshirjes të ketë mundësi që të jetojë në pavarësi dhe me sjellje të mirë duke mos shkel ndonjë normë juridiko-penale.⁴⁴

3.3.2 Parimi i mbrojtjes

Ekzekutimi i dënimit me burg është njëra ndër format kryesore të ekzekutimit të sanksioneve por njëkohësisht edhe më i rëndi dhe nga kjo bëhet e qartë që subjektët ndaj të cilëve shqiptohet ky dënim gëzojnë mbrojtje të caktuar e cila u garantohet. Kur flasim për pjesën e mbrojtjes këtu kemi të bejmë për mbrojtje të integriteti psikofizik dhe moral të personit. Me këtë bëhet e qartë se në momentin kur bëhet ekzekutimi i sanksionit ndaj këtij personi duhet të ketë sjellje korrekte me të cilën në asnjë rast nuk duhet të rrezikohet personaliteti i tij dhe dinjiteti i njeriut, nga shkak që bëhet fjalë për vlera mjaftë të rëndësishme të cilat duhet të respektohen. Më këtë parim ka të bëjë që të mund të mbrohet gjendja dhe integriteti psikofizik i personit i cili është i dënuar ose ndaj të cilit shqiptohet dënimi me burg por të mbrohet edhe integriteti moral i personit.⁴⁵

Nga ky parim kuptojmë që ndalohet çdo formë e cila do ta dëmtonte integritetin fizik dhe moral të personit i cili është i dënuar, më saktë thënë ndalohen të gjitha llojet e torturës, e cila do të kishte ndikim mjaftë negative në shëndetin psikofizik të personit por poashtu do të dëmtonte edhe shëndetin moral të subjektit i cili është i dënuar me burg, ndalohet sjellje jonjerëzore, ngase subjekti i cili është i dënuar, ky dënim nuk vjen si masë e cila duhet të keqtrajtohet ose të sillet me atë subjekt në atë mënyrë që do të dëmtonte shëndetin e tij mendor dhe integritetin e tij psikofizik si dhe ndalohet çdo sjellje e caktuar e cila është nënçmuese ndaj këtij personi ose

⁴⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 14, paragrafi 2

⁴⁵ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 15, paragrafi 1

ndonjë dënim tjetër.⁴⁶

Nga e tërë kjo në mënyrë decide në ligjin për ekzekutimin e sanksioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bëhet e qartës se është e patjetërsueshme që të sigurohet e drejta e sigurisë personal të personit i cili është i dënuar me burg si dhe nevojitet vetërespektim i personalitetit të tij, që do të thotë që secili subjekt ka rëndësinë e vet dhe se personaliteti i secilit ka rëndësi të madhe për atë shkak duhet të respektohet secili nga ata subjekte të cilët janë në burg.⁴⁷

3.3.3 Parimi i sistemimit

Ky është një parim tjetër i cili ndihmon shumë në sëndërtimin e procesit për ekzekutimin e sanksioneve dhe që njëkohësihtë ka ndikim të madhë lidhur me atë se si bëhet shqiptimi ose ekzekutimi i sanksioneve. Me këtë parim nënkuptohet që kryerësit e veprave penale kanë dallime të shumta duke u bazuar në moshën e tyre, gjinin e tyre e shumë fakte të tjera të cilët imponojnë që të bëhet sistemim i të burgosurve në burg.

Pra, me këtë parim nënkuptohet që bëhet një lloj sistemimi i ekzekutimit të dënimit me burg dhe se ky sistemim organizohet në mënyrë që mundet që në institucione të veçuara ose në seksione të veçuara të institucioneve të veçanta dhe në grupe të caktuara të mundet që këto persona të sistemohen në përputhje me faktet të cilat do të konsiderohen si bazike për sistemimin e tyre. Pra, duhet të bëhet sistemim i këtyre personave, klasifikim dhe zhvendosje e kategorive të veçanta të këtyre personave të cilët janë të dënuar që në këtë mënyrë të mund të bëhet zbatim më i lehtë të llojeve të trajtimit të cilët janë të ndryshme për kategori të caktuar të personave të cilët janë të dënuar me burg, por edhe që të ndikohet në parandalimin e ndikimit të ndërsjellë i cili mund të jetë i dëmshëm nga persona të dënuar tek personat tjerë të dënuar dhe që duke bërë sistemimin dhe klasifikimin në këtë mënyrë kjo jep një ndikim të fortë edhe në mbajtjen e disiplinës e cila në këto rrethana ka një ndikim dhe është një faktor mjaftë i rëndësishëm lidhur me ekzekutimin e dënimit me burg.⁴⁸

Ky parim është mjaftë i rëndësishëm për shkak se personat të cilët janë të dënuar me burg sistemohen në institucione të caktuara dhe të ndryshme që të bëhet ekzekutimi i dënimit me burg ndaj tyre, duke pasur parasysh pozitën e tyre dhe se veprohet duke u bazuar në ligjin për

⁴⁶ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 15, paragrafi 2

⁴⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 15, paragrafi 3

⁴⁸ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 16

ekzekutimin e sanksioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në pajtim me vendimin e caktuar të cilin e sjell gjykata.⁴⁹

Sistemi apo ndarja e subjektëve të cilët janë të dënuar me burg bëhet për shumë shkaqe për shkak se ekzekutimi i dënimeve bëhet ndaras në këto raste:

- a) *Personat e gjinisë së kundërt*
- b) *Përsoneat të cilët për herë të parë vuajnë dënimin me burg ndahen prej personave të dënuar të kthyer dhe nëse për atë ekzistojnë kushte hapësinore në institucion*
- c) *Dënim me burg për fëmijët dhe personave në moshë madhore*
- d) *Personat të cilët mbajnë masë paraburgimi dhe personat të cilët vuajnë dënimin me burg*
- e) *Personat të cilët vuajnë dënim me burg të përjetshëm dhe persona të tjerë të dënuar*⁵⁰

Një gjë e tillë është mjaftë e nevojshme për shkak se nuk mundet më një vend të caktuar e që do të ishte i njëjtë të qëndrojnë personat e dënuar me burg të cilët janë të gjinisë së kundërt, për shkak që secili prej atyre grupeve ka nevoja të caktuara që dallojnë nga njëra tjetra dhe poashtu kanë specifika të caktuara që i bën të nevojshme ndarjen e tyre.

Pos kësaj ndarje, sistemimi bëhet edhe për personat të cilët për herë të parë kanë kryer ndonjë vepër penale dhe për të cilën është bërë ekzekutimi i sanksionit ndaj tyre dhe personave të cilët janë kthyer ose kanë kryer për të dytën ose më shumë herë vepër të caktuar penale, kjo ndarje bëhet me qëllim që qëndrimi bashkë i këtyre grupeve mund të ketë ndikime negative ndaj personave të cilët për herë të parë kanë kryer ndonjë vepër penale nga personat të cilët një gjë e tillë e kanë bërë më shumë herë, idea kryesore e ndarjes së këtillë është që sjellja jo e mirë e personave të cilët më shumë herë kanë kryer vepër penale të mos ndikojë ndaj personave të cilët për herë të parë kanë kryer ndonjë vepër të caktuar penale.

Një gjë e cila është mjaftë e rëndësishme është ndarja e fëmijëve nga personat madhor. Njëashtu qëllimi është i njëjtë ngase personat madhor me sjelljen e tyre negative mund të ndikojnë që të ndikojnë tek fëmijët që në të ardhmën ata të veprojnë ose të bjënë ndonjë vepër penale tjetër e cila do të kishte ndikim mjaftë negativ dhe të mos ndikohet që sjellja jo e mirë të

⁴⁹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 17

⁵⁰ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 17

ndikoj tek fëmijët.

Personat të cilët janë në paraburgim nuk mund të qëndrojnë bashkë me personat të cilët gjenden në burg nga shkak që paraburgimi mund të shqiptohet për qëllime të ndryshme dhe se subjekti mund të lirohet nga paraburgimi, ndërsa personat të cilët janë në burg, ndaj tyre është sjell vendimi për një gjë të tillë dhe se bëhet ekzekutim i sanksionit dhe për këtë shkak këto dy kategori nuk mundet të qëndrojnë bashkë dhe se bëhet ndarje mes këtyre kategorive.

Një grup tjetër i cili është i dënuar me burg të përjetshëm ndahen nga subjektët e tjerë të cilët janë të dënuar me dënim me burg por jo me burgim të përjetshëm, për shkak se sjellja ndërmjet këtyre personave mund të ndikoj shumë ndërmjet këtyre grupeve.⁵¹

Një gjë e cila duhet të potencohet është fakti që personat të cilët dënohen me burg ose ndaj të cilëve shqiptohen ose ekzekutohet sanksioni me dënim me burg klasifikohen sipas disa faktorëve që lidhen me pjesën e domosdoshmërisë për aplikim të masave për trajtim dhe llojit të trajtimit i cili është i nevojshëm për këto persona të cilët janë të dënuar me burg, që lidhen me moshën e tyre dhe karakteristikat personale të personave të dënuar me burg.⁵²

Subjekti kompetent i cili bën përcaktimin sa i përket sistemit, klasifikimit dhe zhvendosjes së personave të cilët janë të dënuar me dënim me burg është Ministri i Drejtësisë⁵³.

Këtë gjë Ministri i Drejtësisë e bën me akt të përgjithshëm në të cilën përcaktohet forma se si duhet të trajtohen personat e dënuar me dënim me burg si dhe përcaktohet mënyra se si duhet të trajtohen personat të dënuar me burg.⁵⁴

3.3.4 Parimi i sigurimit të kushteve të duhura gjatë dënimit me burg

Ky parim paraqet një bazament të caktuar lidhur me të drejtat e personave të cilët janë të burgosur, për shkak që personat të cilët janë të burgosur kanë të drejtë të kenë kushte të duhura dhe të përshtatshme me të cilët do t'i mundësohet që sa më lehtë dhe në mënyrë të duhur t'a kalojnë dënimin me burg. Nga kjo kuptohet qartë se të gjithë të burgosurit kanë nevojë për kushte të duhura me të cilat ata do të mund të funksionojnë në mënyrë të lehtë. Ky parim në mënyrë specifike i dedikohet fëmijëve të cilët janë të burgosur ngase për fëmijët kërkojnë

⁵¹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 17

⁵² Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 18

⁵³ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 19, paragrafi 2

⁵⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 19, paragrafi 3

plotësimin dhe sigurimin e kushteve mjaftë adekuate dhe të duhura për shkak se bëhet fjalë për kategori më të ndjeshme dhe që i nevojitet sigurim të kushteve të duhura që ata sa më lehtë të kalojnë dënimin me burg. Kur flasim për sigurimin e kushteve për fëmijët qëllimi është që sigurimi i kushteve të ndikoj në:

- a) *Mbrojtjen nga ndikimi i dëmshëm i personave të tjerë të dënuar*
- b) *Formimi i kushteve për jetë dhe punë*
- c) *Formimi i kushteve për aktivitete kulturore, sportive dhe tjera adekuate për moshën e tyre*

Kjo bëhet me qëllim që sjellja jo e mirë e personave të tjerë të dënuar mos të ndikojë te fëmijët të cilët janë të dënuar me burg dhe për këtë shkak fëmijëve duhet t'u sigurohen kushte të atilla që ndaj tyre të mos ketë ndikime të dëmshme të cilët do të ndikojnë negativisht në sjelljen e tyre ose ndikime të mëtutjeshme të cilat bien ndesh me qëllimin e dënimit të cilin e kanë e që është dënimi me burg. Por, sigurimi i kushteve duhet që të ndikoj edhe në pjesën e jetës dhe punës për fëmijët, që ata të mund të punojnë dhe të aftësohen por njëkohësisht që të kenë edhe aktivitete të ndryshme me të cilat do të ndikohet në mënyrë të mirë dhe specifike te fëmijët dhe si aktivitete të tilla janë aktivitetet kulturore të cilat mund të jenë të ndryshme por të cilat kanë ndikim mjaftë të madhë te fëmijët, më pas aktivitetet sportive që nënkuptohet që ata të kenë edhe aktivitete fizike me të cilat do të ndikon edhe në shëndetin e tyre fizik por edhe në shëndetin e tyre psikik dhe aktivitete të tjera të cilat do të jenë adekuate për moshën e tyre.⁵⁵

Në kuadër të kësaj duhet theksuar që njëra ndër gjërat mjaft të rëndësishme është akomodimi i të burgosurve. Kjo tregon qartë se personat të cilët janë të dënuar me burg duhet të akomodohen në dhoma të veçanta për fjetje, mirëpo kjo varet shumë edhe prej faktit që në institucion të ketë hapësirë që të mundet secili prej të burgosurve të vendoset në dhomë ndaras për fjetje, për shkak që kjo do të bënte që dënimi të kalontë me lehtë dhe të burgosurit të ndjehen më mirë.⁵⁶

Një gjë mjaftë e rëndësishme është së personat e burgosur ndahen në grupe të caktuara dhe një ndarje e këtillë ndikon shumë në pjesën e zbatimit të masave të caktuar te ata të burgosur. Nga kjo kuptojmë se personat të cilët janë të dënuar me burg në bazë të grupit këto sistemohen

⁵⁵ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 20

⁵⁶ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 21, paragrafi 1

në grupe në të cilat mund të zbatohen masa të caktuara sikur masat e edukimit dhe riedukimit të llojit të njejtë, që do të thotë që secili grupohet në bazë të masave të njejtë që duhet të zbatohen me qëllim që të njejtë mos të zbatohen ndaras, por që të burgosurit i një grupi të caktuar në rast se kanë nevojë për një masë të njejtë grupohen në një grup të njejtë me qëllim të efikasitetit të asaj mase, ndërsa grupi tjetër që ka nevojë për zbatim të ndonjë mase tjetër atëherë ata grupohen në grup tjetër.⁵⁷

Në kuadër të parimeve në flasim edhe për pjesën e detyrimeve të cilat i kanë personat e dënuar me dënim me burg dhe personat të cilët janë në paraburgim. Në kuadër të kësaj ajo e cila është e rëndësishme është se personat të cilët janë të dënuar me burgim dhe personat të cilët janë në paraburgim janë të detyruar që t'i respektojnë të gjitha dispozitat e caktuara të cilat janë pjesë e rendit të institucionit, kjo nënkupton që personat e dënuar dhe personat të cilët janë në paraburgim duhet të sillen në përputhje me këto rregulla që janë në institucion.⁵⁸

Lidhur me pjesën e disiplinës në institucionin në të cilin bëhet ekzekutimi i sanksionit që në rastin konkret është ekzekutimi i dënimit me burg, kjo bëhet në mënyrë të drejtë, kjo nënkupton që ndaj të gjithëve kanë qasje të njejtë dhe të drejtë, të rreptë, që nënkuptohet që bëhet fjalë për disiplinë të një niveli mjaftë të lartë ku gjërat bëhen në mënyrë mjaftë rigorozë por jo në kuptim negativ, por në kuptim të nivelit të disiplinës brenda institucionit si dhe me respektim të personaliteti njerëzor, kjo arrihet duke pas një sjellje njerëzore dhe duke ndaluar të gjitha format e trajtimit jo të mirë me të cilën do të kishte ndikim negativ në personalitetin e secilit person i cili është i burgosur.⁵⁹

Një gjë e cila është mjaftë e rëndësishme është fakti se ndalohet dënimi kolektiv i personave të cilët janë të dënuar me burg. Kjo nënkuptohet se secili dënohet veç dhe se nuk mundet ndaj të gjithëve të ketë dënim të njejtë ose të dënohen në mënyrë kolektive, por që për secilin ka dënim të caktuar dhe assesi kjo nuk guxon që të jetë në formë kolektive.⁶⁰

Kur flasim për pjesën e respektimit të dinjitetit dhe personalitetit të personave të burgosur këtu ka shumë faktor të cilët ndikojnë dhe madje këto janë të ndaluara në mënyrë mjaftë strikte me të cilën nënkuptohet që ndalohet që të përdoret ndonjë mjet i caktuar që shërben për detyrim si dënim. Kjo nënkuptohet që nuk guxon që ndaj personit i cili është i burgosur të përdoret

⁵⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 21, paragrafi 2

⁵⁸ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 22, paragrafi 1

⁵⁹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 22, paragrafi 2

⁶⁰ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 22, paragrafi 3

ndonjë mjet për detyrim si dënim për personin i cili është i burgosur. Me këtë nënkuptohet qartë se respektohet dinjiteti i secilit person të burgosur dhe se nuk lejohet që këto të detyrohen dhe këtë ta kenë në formë të dënimit.⁶¹

Kur flasim për pjesën e dënimit me burg një gjë e cila është e nevojshme është fakti se personat të cilët janë të burgosur dhe personat e paraburgosur nevojiten që të kenë mbrojtje të caktuar shëndetësore. Kjo ndikon shumë në shëndetin e personave të burgosur dhe atyre të paraburgosur, sidomos në shëndetin psikik të tyre dhe se një mbrojtje e tillë bënë pjesë tek sjellja e mirë dhe njerëzore ndaj personave të burgosur dhe të paraburgosur dhe kjo tregon një shenjë të kujdesit e që është shumë e rëndësishme për personat të cilët gjenden në burg dhe për personat të cilët janë të paraburgosur.⁶²

Kur flasim për personat e dënuar me burg dhe personat në paraburgim, kjo nuk do të thotë që ndaj tyre duhet të ketë sjellje çfarëdo qoftë ajo dhe nuk nënkuptohet që ndaj këtyre personave të bëhen eksperimente të ndryshme mjekësore ose eksperimente tjera me të cilat do të ndikonin që të vendosin në rrezik këta persona por gjithashtu kjo do të kishte një ndikim të madhë për cënimin e integritetit fizik, psikik dhe moral të personave të cilët janë të dënuar. Më këtë bëhet e qartë se ndalohet në mënyrë strikte të që ndaj këtyre personave të bëhen eksperimente të këtilla, për shkak se dinjiteti i secilit person që është në burg ka rëndësi të vet dhe se nuk guxon që të cënohet personaliteti i asnjërit nga ata persona.⁶³

3.3.5 Parimi i punës në burg

Ky parim është njëri ndër parimet më të rëndësishme ngase personave të cilët janë në burg u mundëson që të merren me ndonjë angazhim të caktuar i cili është i nevojshëm edhe përderisa gjenden në burg por edhe pasi që dalin prej burgut. Nga kjo kuptojmë që me këtë parim bëhet e qartë se personave të cilët janë të dënuar me burgim është e detyrueshme që t'i mundësohet punë e caktuar të cilën ata do ta bëjnë për sa kohë do të jenë në burg dhe kjo punë duhet të jetë e dobishme dhe adekuate jo vetëm për faktin se sa ata do të jenë në burg por të jetë e dobishme edhe pas saj që do të thotë në liri. Me këtë nënkuptohet që këto persona aftësohen që të punojnë edhe brenda institucionit por që do të bëjnë punë e cila do të jetë e nevojshme edhe pasi

⁶¹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 22, paragrafi 4

⁶² Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 23, paragrafi 1

⁶³ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 23, paragrafi 2

që të lirohen nga burgu, gjë që është e duhur për të gjithë personat e burgosur.⁶⁴

Këtu flasim për punën si një gjë mjaftë e rëndësishme për personat të cilët janë në burg, për shkak se ky parim i mundëson atyre që të fitojnë dhe të zhvillojnë shprehitë e punës, gjë që është shumë e rëndësishme, për shkak se edhe pse ata janë në burg në kuadër të kësaj ata nuk ngelen pasiv por bëhen aktiv dhe angazhohen me punë që i ndihmon atyre edhe përdërisa gjenden në burg por që i ndihmon edhe në pjesën e zhvillimit të shprehive të punës që është shumë e nevojshme për pjesën kur gjenden në liri, por pos kësaj duke punuara ata i mirëmbajnë aftësitë e tyre të punës, që do të thotë nuk i humbin ata aftësi të cilat i kanë pasur para se të hyn në burg dhe se duke punuar ndikon që ata t'i mirëmbajnë këto aftësi dhe një gjë mjaftë e rëndësishme është se gjatë punës ata fitojnë dituri profesionale që ka një rëndësi mjaftë të madhe për punën në liri.⁶⁵

Në kuadër të kësaj kur flasim për anët pozitive të cilët i kanë të burgosurit duke punuar përderisa janë në burg, pos kësaj ata kanë trajtim mjaftë të mirë duke pasur parasysh faktin se puna në burg nuk nënkupton që ata të punojnë duke kaluar kufizimet të cilët janë të përcaktuar lidhur me punën në përgjithësi. Nga kjo kuptojmë që personat të cilët janë të dënuar nuk guxohet që përdërisa ata punojnë të kërkohet ndonjë punë e cila do të jetë ndoshta e rrezikshme ose e dëmshme për shëndetin e tyre, ngase puna duhet t'i ndihmojë atyre në anën pozitive që të njejtën ta bëjnë përderisa janë në burg por edhe të bëjnë kur të jenë në liri dhe jo puna të ndikojë keq në shëndetin e tyre, për shkak se një gjë e tillë është e ndaluar.⁶⁶

Në këtë pjesë kur flasim që punën të cilët e bëjnë personat të cilët janë të burgosur dhe se këtë punë duhet të bëjnë në kuadër të mundësive të tyre që më pas ajo t'i ndihmon ata edhe përderisa gjenden brenda në burg por edhe kur të jenë në liri, kjo nënkuptohet që ndalohet që ata të punojnë në mënyrë të pakufizuar. Në këtë pjesë kemi të bëjmë që orari i punës të cilën e bëjnë personat e burosur nuk duhet të jetë më tepër se sa orari i punës që e bëjnë personat në liri. Me këtë e kemi të qartë se në asnjë rast nuk lejohet që orari të cilin punojnë personat e burgosur të jetë më i gjatë se sa orari i personave të cilët punojnë në liri, gjë që ky orar është e detyrueshme të jetë në harmoni me orarin e punës në liri.⁶⁷

Kur flasim për pjesën e parimeve, parimet të cilat i cekëm më lartë janë parime të cilat

⁶⁴ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 24, paragrafi 1

⁶⁵ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 24, paragrafi 2

⁶⁶ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 24, paragrafi 3

⁶⁷ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Republika e Maqedonisë së Veriut, neni 24, paragrafi 4

rrjedhin nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve dhe që paraqiten si një sëndërtues të dënimit me burg, mirëpo pos këtyre parimeve do të përmendim edhe disa parime të tjera të cilat janë pjesë e doktrinës juridike por që nënkuptohet që edhe ato rrjedhin dhe bazohen në ligj. Këto parime konsiderohen si sëndërtues të dënimit me burg dhe se në bazë të këtyre parimeve bëhet organizimi dhe mënyra e shqiptimit të dënimit me burg, që nënkuptohet që këto paraqiten si postulate më të rëndësishme kur vjen në shprehje dënimi me burg.

Si parime të këtyra të cilat kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit me burg janë:

- a) Parimi i ligjshmërisë*
- b) Parimi i humanitetit*
- c) Parimi i individualizimit*
- d) Parimi i mbajtjes së përbashkët të dënimit*
- e) Parimi i punës së detyrueshme të personave të dënuar*
- f) Parimi i ndihmës postpenale* ⁶⁸

Parimi i ligjshmërisë është njëri ndër parimet esenciale që ka rol kryesor gjatë zbatimit të dënimit me burgim. Më këtë parim tentohet që të arrihet një lloj sigurie se ndaj personave të cilët janë të dënuar me burg nuk do të ndërmerren veprime që nuk janë të parapara më parë me ligj. Pra, parimi i ligjshmërisë nënkupton që organet duhet të ndërmarrin vetëm ata veprime të cilat janë të parapara më parë me ligj dhe se punëtorët të cilët janë në institucionet korrektuese nuk mundët që të ndërmarrin ndonjë veprim të caktuar ndaj personave të cilët janë të dënuar me burgim nëse ai veprim nuk është paraparë me norma dhe dispozita ligjore. Ky parim njëkohësisht paraqet se dënimet të cilat janë të shqiptuara të njëjtat mundet të ekzekutohen vetëm në atë kohë dhe vetëm në atë mënyrë se si është e paraparë me ligj. Me këtë parim njëkohësisht nënkuptohet që personat të cilët janë të dënuar për aq kohë sa qëndrojnë në këto ente, mundet të kufizohen në disa të drejta të caktuara deri në atë masë se si të njëjtat janë të përcaktuara me ligj. ⁶⁹

Parimi i humanitetit është një parim tjetër që ka një rëndësi të madhe në pjesën e ekzekutimit të dënimit me burg. Më këtë parim nënkuptohet që ndaj personave të cilët janë të

⁶⁸ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 207

⁶⁹ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 207, 208

dënuar duhet të ketë sjellje korrekte dhe humane dhe të respektohet personaliteti i njeriut dhe dinjiteti i tij si pjesë mjaftë të veçanta. Me këtë parim bëhet e qartë se subjekti i cili është i dënuar nga shkaku që ka kryer vepër të caktuar penale, nuk është zhveshur nga subjektiviteti i tij njerëzor, që do të thotë ai ende ngelet njeri. Me këtë parim nënkuptohet respektim i dinjitetit të personit të dënuar pavarësishtë dallimeve të caktuara qofshin ato nacionale, etnike, racore dhe fetare të personave të cilët janë të dënuar.⁷⁰

Parimi i individualizimit është një parim i atillë që përcakton trajtimin ndaj personave të dënuar. Kjo do të thotë që ekzekutimi i dënimit me burgim, duhet t'i përshtatet vetive të tyre fizike dhe psikike. Kjo ngase kjo është mjaftë e rëndësishme që të mundet që ato persona të risocializohen ose të riintegrohen. Me këtë parim bëhet e qartë se të gjitha veprimet, mjetet dhe metodat që ndërmirren ndaj një personi i cili është i dënuar me dënim me burg, duhet që të njejtat t'i përshtaten cilësive dhe vetive të atij personi i cili është i dënuar me dënim me burg.⁷¹

Parimi i mbajtjes së përbashkët të dënimit është parim i cili ka për qëllim që të ndihmon që më lehtë të bëhet procesi i risocializimit të personave të dënuar në burg. Ky parim arrihet në ato raste kur personat të cilët janë të dënuar dënimin e mbajnë në grupe dhe nëngrupe të caktuara me qëllim që ata të mund të risocializohen. Nga kjo kuptojmë që personat të cilët janë të dënuar me dënim me burg, nuk nënkuptohet që ata duhet të izoloohen dhe të mos shoqërohen me njëri tjetrin por ata duhet të punojnë dhe të shoqërohen në mënyrë kolektive që sa më lehtë më pas të riintegrohen në shoqëri.⁷²

Parimi i punës së detyrueshme të personave të dënuar ky parim nuk është vetëm një parim por është edhe një pjesë mjaftë e rëndësishme gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim, për shkak se në bazë të këtij parimi tregohet dhe specifikohet se të gjithë persona e dënuar me burgim duhet në mënyrë të detyrueshme të punojnë dhe duhet t'u mundësohet punë atyre. Më herët ky parim nuk e ka pasur qëllimin që ka sot, ngase më herët puna ka qenë një lloj i dënimit plotësues për shkak se ka qenë punë mjaftë e vështirë dhe qëllim kryesor ka qenë shkaktimi i mundimeve, ndërsa sot me punë nuk është ky qëllim por që puna në rastin e tillë ka për qëllim

⁷⁰ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 209

⁷¹ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 210

⁷² Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 210, 211

rritjen e shprehive të punës, formimin e shprehive të reja të punës dhe aftësim të këtyre personave që të punojnë në mënyrë të pavarur në liri. Ajo e cila është e rëndësishme shihet qartë se më herët puna në burg ka pasur për qëllim që të shkaktoj edhe më shumë mundim për personat e burgosur, përderisa sot puna në burg ka për qëllim që t’ua lehtësoj atyre dhe të munden që në mënyrë të pavarur të punojnë në liri. Këtu kemi përjashtime vetëm për personat të cilët janë të paaftë dhe janë të sëmurë e që janë në burg.⁷³

Parimi i ndihmës postpenale është parim i fundit por jo më pak i rëndësishëm se parimet paraprake ngase ka rëndësi të madhe për arsye se personat të cilët janë të dënuar dhe të cilët kanë qëndruar një kohë të gjatë në burg, atyre i ndihmohet që në mënyrë sa më të lehtë dhe pa problem të munden të përfshihen në jetën në liri.⁷⁴

⁷³ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 211

⁷⁴ Dr. Halili, Ragip, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009, fq. 212

KAPITULLI IV

4.1 Studim hulumtues lidhur me sanksionin penal dënim me burg në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga periudha 2015 – 2020

Studimi i cili do të paraqitet do të jetë mjaftë përmbajtësor në të cilën do të ketë elemente mjaftë të rëndësishme lidhur me sanksionet penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më saktë thënë për sanksionin e ekzekutimit të dënimit me burg me të cilën do të bëhet një pasqyrim i realtë lidhur me një periudhë mjaftë të gjatë kohore me të cilën do të shihet qartë se sa është numri i veprave penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut brenda periudhës nga viti 2015 deri në vitin 2020.

Në këtë aspekt do të paraqesim tabelë për secilin vit veç e veç me të cilën do të jetë në mënyrë mjaftë specifike për secilin vit ku në të do të përfshijmë numrin total të veprave penale të cilët janë kryer për vitin përkatës, qytetin në të cilin janë kryer veprat penale, numrin e personave të dënuar që në këtë pjesë do të përfshijmë edhe numrin e gjinisë femrore të cilët paraqiten si kryerës të veprave penale dhe në fund do të paraqesim numrin e personave të cilët janë të dënuar me burg.

Këto të dhëna janë të dhëna të cilat janë të paraqitura nga ana e Enti Shtetëror i Statistikave të cilët i kanë paraqitur këto të dhëna nga ku edhe jemi bazuar dhe i kemi paraqitur të dhënat të cilat lidhen për kryerjen e veprave penale por edhe të dënimit me burg.

Në vijim do të paraqesim tabela për secilin vit në mënyrë më specifike ku do të paraqesim të dhënat të cilat janë nga ana e Prokurorive Themelore Publike por edhe nga ana e Gjykatave Themelore me të cilat në mënyrë mjaftë specifike përcaktohen kryerësit e veprave penale dhe dënimi me burg për të njejtat.

Në pjesën e mëposhtme do të paraqesim tabela dhe përshkrim vetëm në tabelën e parë , e më pas do të vijon në të njejtën formë, por pa përshkrim ngase nënkuptohet.⁷⁵

⁷⁵ <https://www.stat.gov.mk/PrethodniSooptstenijaOblast.aspx?id=14&rbrObl=6>

4.2 Të dhëna për vitin 2015

Tabela numër 1 – Të dhëna për vitin 2015 – Të rriturit e raportuar

	Gjithsej kryerësit e njohur
Gjithsej	15 408
Prokuroritë Themelore Publike	
Dibër	116
Kërçovë	449
Ohër	175
Manastir	1845
Prilep	760
Kavadarci	199
Gevgeli	426
Veles	411
Kriva Palankë	225
Kumanovë	402
Gostivar	98
Tetovë	1257
Delçevë	229
Berovë	124
Ravodish	165
Sveti Nikol	132
Strumicë	721
Koçani	533
Shtip	302
Shkup	5855
Shkup – krim i organizuar	201
Resnje	29
Strugë	757

Kjo tabelë është e marrur nga statistikat dhe të dhënat të Entit Shtetëror të Statistikës në të cilën përfshihet në kuadër të njoftimit i cili është në fushën e Gjyqësorit në të cilën janë të pasqyruar personat e raportuar, akuzuar dhe të dënuar të cilët janë personat e rritur kryerës të veprave penale dhe fëmijet në vitin 2015.

Në këtë njoftim ka të dhëna më të shumta lidhur me llojet e dënimeve por ne kemi pasqyruar numrin e personave të cilët kanë kryer vepra penale gjatë vitit 2015 me të cilën këtë numër e kemi pasqyruar në kuadër të disa qyteteve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me të cilin mund të vërejm se në cilin qytet sa është numri i kryerësve të veprave penale dhe sa është numri i veprave penale.

Në këtë tabelë në mënyrë të qartë janë të dhëna të cilat janë të marra nga gjykatat themelore që pasqyrojnë numrin e veprave penale dhe në cilat qytete ndodhin këto vepra penale.

Në njoftimin që jipet nga Enti Shtetëror i Statistikës ne kemi paraqitur vetëm numrin e kryerësve të veprave penale dhe qytetet ku janë kryer veprat penale.


Në këtë rast e shohim që numri i madhë i veprave penale vjen nga Shkupi që ka një dallim mjaft të madhë me qytete tjera, por njëashtu shohim se lartësia e numrit ka një rëndësi mjaft të madhe me madhësinë e qytetit.

Në këtë tabelë janë të paraqitur personat e raportuar të moshës madhor dhe që është një përfshirje e numrit të veprave penale që janë kryer gjatë vitit 2017.⁷⁷

⁷⁶ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?id=14&rbr=2014> - <https://www.stat.gov.mk/pdf/2016/2.1.16.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

⁷⁷ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?id=14&rbr=2014> - <https://www.stat.gov.mk/pdf/2018/2.1.18.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021

Gjithsej - 15 408



78

⁷⁸ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2014> -
<https://www.stat.gov.mk/pdf/2016/2.1.16.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

Tabela numër 2 personat e dënuar sipas gjykatave themelore – viti 2015

	Të dënuar	Femra	Dënimet gjithsej	Dënime burg me
Gjithsej	10312	865	5848	3524
Dibër	90	6	90	72
Resnjë	83	6	204	-
Strugë	211	6	204	97
Kërçovë	248	22	98	39
Ohër	373	24	222	131
Krushevë	27	-	15	2
Manastir	196	27	49	22
Prilep	860	92	830	567
Kavadarci	225	27	39	9
Negotinë	160	18	66	36
Gevgeli	62	8	31	5
Veles	440	41	439	358
Kriva Pallankë	44	3	17	13
Kumanovë	84	9	36	27
Kratovë	29	-	29	16
Gostivar	154	3	34	21
Tetovë	566	24	282	98
Delçevë	68	7	68	41
Berovë	41	2	32	9
Radovish	112	15	70	20
Sveti Nikole	176	16	163	88
Strumicë	380	23	204	100
Koçani	320	35	137	75

Shtip	466	44	208	119
Shkup 1	4471	380	2080	1256
Vinicë	57	4	55	32
Shkup – krim i organizuar	369	23	327	271

79

Në këtë tabelë janë të përfshirë të dhëna të tjera të cilat në vete pasqyrojnë numrin e personave të cilët kanë qenë të dënuar dhe ndaj të cilëve janë shqiptuar dënime të ndryshme, por që në rastin konkret ne kemi paraqitur vetëm ato rastet në të cilat si dënim është shqiptuar dënimi me burg.

Duke pasur parasysh se jo gjithmonë si kryerës të veprave penale paraqiten meshkujt, nga shkakut që numri më i madhë i personave që kryejnë vepra penale janë meshkuj nuk do të thotë që në këtë kategori nuk ka femra, në lidhje me këtë në këtë tabelë kemi paraqitur edhe numrin e femrave ndaj të cilave është shqiptuar dënimi.

Në këtë tabelë janë të paraqitura qytetet në të cilat janë kryer veprat penale dhe kjo duke u bazuar në të dhënat të cilat kanë qenë të marrura nga ana e Gjykatave Themelore dhe të cilat janë të publikuara nga ana e Entit Shtetëror të Statistikës.

Qytetet janë një kategori, më pas kemi paraqitur numrin e personave të dënuar në të cilat ka një ndarje ku në me një pjesë përcaktojmë edhe numrin e kryerësve të veprave penale që janë femra. Duke pasur parasysh se janë shqiptuar dënime të ndryshme, në këmi paraqitur vetëm dënimin me burg, nga shkakut që ajo është pjesa kryesore për të cilën kemi biseduar në këtë punim.⁸⁰


⁷⁹<https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?id=14&rbr=2014> - <https://www.stat.gov.mk/pdf/2016/2.1.16.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 4

⁸⁰<https://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?id=14&rbr=2014> - <https://www.stat.gov.mk/pdf/2018/2.1.18.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021

4.3 Të dhëna për vitin 2016

Tabela numër 1 – Të dhëna për vitin 2016 – Të rriturit e raportuar

	Gjithsej kryerësit e njohur
Gjithsej	11866
Prokuroritë Themelore Publike	
Dibër	83
Kërçovë	469
Ohër	245
Manastir	953
Prilep	637
Kavadarci	242
Gevgeli	334
Veles	342
Kriva Palankë	172
Kumanovë	647
Gostivar	62
Tetovë	1191
Delçevë	174
Berovë	122
Ravodish	180
Sveti Nikol	128
Strumicë	741
Koçani	368
Shtip	171
Shkup	3976
Shkup – krim i organizuar	131
Resnje	71
Strugë	427



⁸¹ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2334> -
<https://www.stat.gov.mk/pdf/2017/2.1.17.18.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

⁸² <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2334> -
<https://www.stat.gov.mk/pdf/2017/2.1.17.18.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

Tabela numër 2 personat e dënuar sipas gjykatave themelore – viti 2016

	Të dënuar	Femra	Dënimet gjithsej	Dënime me burg
Gjithsej	8172	723	3834	1922
Dibër	69	1	69	50
Resnjë	46	8	9	3
Strugë	142	13	119	26
Kërçovë	207	11	82	40
Ohër	357	30	179	86
Krushevë	35	1	17	7
Manastir	325	33	144	80
Prilep	643	84	387	171
Kavadarci	151	9	53	29
Negotinë	64	6	21	12
Gevgeli	415	51	188	48
Veles	344	20	175	121
Kriva Pallankë	26	2	18	8
Kumanovë	62	8	10	4
Kratovë	18	-	5	1
Gostivar	128	3	49	36
Tetovë	765	39	318	80
Delçevë	53	6	42	18
Berov	41	6	27	6
Radovish	118	7	61	8
Sveti Nikole	76	11	75	33

Strumicë	416	45	146	77
Koçani	166	13	66	33
Shtip	557	65	172	106
Shkup 1	2662	234	1183	649
Vinicë	56	5	48	34
Shkup – krim i organizuar	230	12	171	156


83

⁸³ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2334> -
<https://www.stat.gov.mk/pdf/2017/2.1.17.18.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 4

4.4 Të dhëna për vitin 2017

Tabela numër 1 – Të dhëna për vitin 2017 – Të rriturit e raportuar

	Gjithsej kryerësit e njohur
Gjithsej	10603
Prokuroritë Themelore Publike	
Dibër	70
Kërçovë	388
Ohër	187
Manastir	716
Prilep	583
Kavadarci	252
Gevgeli	300
Veles	387
Kriva Palankë	156
Kumanovë	651
Gostivar	118
Tetovë	952
Delçevë	185
Berovë	142
Ravodish	106
Sveti Nikol	135
Strumicë	640
Koçani	200
Shtip	288
Shkup	3662
Shkup – krim i organizuar	82
Resnje	57
Strugë	346



⁸⁴ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2652> - <https://www.stat.gov.mk/pdf/2018/2.1.18.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.202, fq. 2

⁸⁵ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2652> - <https://www.stat.gov.mk/pdf/2018/2.1.18.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.202, fq. 2

Tabela numër 2 personat e dënuar sipas gjykatave themelore – viti 2017

	Të dënuar	Femra	Dënimet gjithsej	Dënime me burg
Gjithsej	6273	550	2739	1255
Dibër	40	-	40	37
Resnjë	36	2	4	2
Strugë	116	12	110	41
Kërçovë	212	21	74	34
Ohër	182	17	81	17
Krushevë	22	2	12	3
Manastir	330	35	124	70
Prilep	533	62	247	107
Kavadarci	268	25	76	30
Negotinë	60	5	50	36
Gevgeli	219	18	89	20
Veles	374	28	122	65
Kriva Pallankë	37	2	13	10
Kumanovë	183	13	81	45
Kratovë	9	-	1	-
Gostivar	215	7	64	26
Tetovë	625	29	273	80
Delçevë	43	-	36	19
Berovë	100	10	37	11
Radovish	135	10	66	17
Sveti Nikole	88	8	86	36
Strumicë	396	46	106	51
Koçani	232	20	68	30

Shtip	443	38	152	97
Shkup 1	1184	132	569	236
Vinicë	63	3	54	44
Shkup – krim i organizuar	128	5	104	91


⁸⁶

⁸⁶ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2652> -
<https://www.stat.gov.mk/pdf/2018/2.1.18.17.pdf> - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 4

4.5 Të dhëna për vitin 2018

Tabela numër 1 – Të dhëna për vitin 2018 – Të rriturit e raportuar

	Gjithsej kryerësit e njohur
Gjithsej	11609
Prokuroritë Themelore Publike	
Dibër	93
Kërçovë	366
Ohër	160
Manastir	859
Prilep	505
Kavadarci	204
Gevgeli	288
Veles	472
Kriva Palankë	209
Kumanovë	811
Gostivar	440
Tetovë	1101
Delçevë	165
Berovë	113
Ravodish	135
Sveti Nikol	142
Strumicë	639
Koçani	185
Shtip	262
Shkup	3869
Shkup – krim i organizuar	86
Resnje	394
Strugë	111



⁸⁷ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2985> - https://www.stat.gov.mk/pdf/2019/2.1.19.17_mk.pdf - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

⁸⁸ <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2985> - https://www.stat.gov.mk/pdf/2019/2.1.19.17_mk.pdf - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

Tabela numër 2 personat e dënuar sipas gjykatave themelore – viti 2018

	Të dënuar	Femra	Dënimet gjithsej	Dënime me burg
Gjithsej	5857	419	2403	1246
Dibër	61	3	34	29
Resnjë	69	5	17	-
Strugë	98	2	63	24
Kërçovë	173	15	79	32
Ohër	176	15	85	44
Krushevë	4	1	1	-
Manastir	248	11	106	73
Prilep	582	53	260	147
Kavadarci	278	27	95	63
Negotinë	51	2	12	9
Gevgeli	259	20	89	27
Veles	354	20	112	73
Kriva Pallankë	33	2	3	1
Kumanovë	100	4	38	16
Kratovë	13	-	3	-
Gostivar	58	-	27	9
Tetovë	680	34	275	99
Delçevë	65	1	41	12
Berovë	57	4	25	4
Radovich	139	8	65	8
Sveti Nikole	77	9	40	22
Strumicë	418	33	130	78

Koçani	273	19	85	41
Shtip	483	39	167	113
Shkup 1	961	82	469	268
Vinicë	54	3	25	7
Shkup – krim i organizuar	93	7	57	47


⁸⁹

⁸⁹<https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=2985> -
https://www.stat.gov.mk/pdf/2019/2.1.19.17_mk.pdf - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 4

4.6 Të dhëna për vitin 2019

Tabela numër 1 – Të dhëna për vitin 2019 – Të rriturit e raportuar

	Gjithsej kryerësit e njohur
Gjithsej	12255
Prokuroritë Themelore Publike	
Dibër	96
Kërçovë	339
Ohër	94
Manastir	811
Prilep	925
Kavadarci	447
Gevgeli	323
Veles	477
Kriva Palankë	138
Kumanovë	581
Gostivar	592
Tetovë	1119
Delçevë	137
Berovë	104
Ravodish	154
Sveti Nikole	132
Strumicë	714
Koçani	66
Shtip	204
Shkup	4059
Shkup – krim i organizuar	176
Resnje	96
Strugë	471



⁹⁰<https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=13376> -
https://www.stat.gov.mk/pdf/2020/2.1.20.17_mk.pdf - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

⁹¹<https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=13376> -
https://www.stat.gov.mk/pdf/2020/2.1.20.17_mk.pdf - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 2

Tabela numër 2 personat e dënuar sipas gjykatave themelore – viti 2019

	Të dënuar	Femra	Dënimet gjithsej	Dënime burg me
Gjithsej	4712	410	2186	1181
Dibër	37	1	24	24
Resnjë	51	2	10	2
Strugë	108	6	79	33
Kërçovë	131	14	48	13
Ohër	54	4	34	24
Krushevë	28	1	11	1
Manastir	301	30	124	60
Prilep	373	40	258	134
Kavadarci	180	17	63	40
Negotinë	31	4	7	1
Gevgeli	194	15	72	33
Veles	297	29	95	59
Kriva Pallankë	21	1	8	6
Kumanovë	182	7	75	40
Kratovë	17	1	10	10
Gostivar	47	1	47	41
Tetovë	461	29	181	95
Delçevë	63	2	31	6
Berovë	54	6	22	4
Radovish	54	3	34	10
Sveti Nikole	114	17	88	50
Strumicë	396	47	188	66
Koçani	284	26	97	63

Shtip	411	47	118	67
Shkup 1	673	52	341	212
Vinicë	27	3	14	4
Shkup – krim i organizuar	132	5	107	83

⁹²

⁹² <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=14&rbr=13376> -
https://www.stat.gov.mk/pdf/2020/2.1.20.17_mk.pdf - e marrur me datë 26.03.2021, fq. 4

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
	Meshkuj	Meshkuj	Meshkuj	Meshkuj	Meshkuj	Meshkuj
	2982	2871	2688	1901	1884	1844

Në këtë tabelë e kemi të paraqitur numrin e personave ndaj të cilëve është zbatuar dënimi me burg gjatë vitit kalendarik përkatës të cilët i kemi paraqitur në tabelë duke filluar nga viti 2015 e deri më vitin 2020. Pra, bëhet fjalë për një reflektim të qartë të numrit të personave të cilët janë të dënuar gjatë kësaj periudhe kohore dhe të njëjtit duke i ndarë në bazë të gjinise. Në këtë tabelë, kemi paraqitur vetëm gjinin mashkullore, ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me burg gjatë kësaj periudhe dhe në bazë të kësaj e shohim qartë se numri i tyre prej vitit 2015 bie ndjeshëm deri në vitin 2020.

Në vitin 2015 dënimi me burg është shqiptuar gjithsej 2982 meshkujve që në kuadër të kësaj tabele e shohim që është një vit me një numër mjaftë të madhë të personave të cilët janë të dënuar me burg. Në vitin 2016, ky numër bie në 2871, por prap ngelet mjaftë i lartë. Në vitin 2017 numri i personave ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me burg është 2688, në vitin 2018 është 1901, në vitin 2019 është 1884, ndërsa në vitin 2020 është numër më i vogël duke u bazuar në këtë tabelë e që është 1844.

Këto janë numra të cilët janë të paraqitur në varësi të numrit të personave të cilët janë të dënuar me dënim me burg gjatë kësaj periudhe kohore nga viti 2015 e deri më 2020, vetëm për gjininë mashkullore, ndërsa më poshtë vijon tabela të cilën do ta paraqesim për gjinin femrore por njëkohësishtë duke ia bashkangjitur edhe gjithsej numrin së bashku me të dy gjinitë.

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
	Femra	Femra	Femra	Femra	Femra	Femra
	109	97	71	53	54	57
Gjithsej Meshkuj / Femra	3087	2968	2759	1954	1938	1901
Të dhënat janë të gjitha deri më datën 31.12						

Në tabelën tjetër të cilën i kemi paraqitur të dhënat ka të bëjë me shqiptimin e dënimit me burg ndaj gjinis femrore, por njëkohësisht duke përfshi edhe numrin e përbashkët të të dy gjinive gjatë periudhës kohore prej vitit 2015 e deri më vitin 2020.

Në këtë pjesë kemi paraqitur numrin e personave ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me burg, por që i përkasin gjinisë femrore gjatë periudhës kohore prej viti 2015 e deri më 2020. Në vitin 2015 ka pasur 109 femra të cilat kanë qenë të dënuar me burg, në vitin 2016 kanë qenë 97, në vitin 2017 numri i femrave ndaj të cilave është shqiptuar dënimi me burg ka qenë 71, në vitin 2018 ka qenë 53, në vitin 2019 ka qenë 54 dhe në vitin 2020 ka qenë 57.

Në këtë pjesë kemi paraqitur edhe numrin gjithsej të personave të dënuar duke i bashkangjitur sikur meshkujt ashtu edhe femrat dhe numrat janë si vijon: në vitin 2015 numri gjithsej ka qenë 3087, në vitin 2016 numri ka qenë 2968, në vitin 2017 numri ka qenë 2759, në vitin 2018 numri ka qenë 1954, në vitin 2019 numri ka qenë 1938, në vitin 2020 numri ka qenë 1901.

Përfundim dhe rekomandime

Në këtë punim kemi paraqitur një pasqyrë të qartë për një periudhë mjaftë të gjatë kohore lidhur me kryerësit e veprave penale dhe dënimin e tyre, më saktë thënë dënimin me burg të tyre.

Në kuadër të kësaj e kemi të qartë se ka dallim të madhë mes kryerësve duke filluar nga gjinia e tyre që realisht meshkujt janë më të prirur për të kryer vepra penale se sa femrat.

Mosha më problematike që paraqitet në tabelat më lartë shihet që është mosha rreth 30 deri 50 vite që paraqitet një numër më i madhë i kryerësve të veprave penale.

Ndërsa aspekti i nivelit të arsimit shihet qartë se ka ndikim të madhë, ku subjektët të cilët nuk kanë kryer shkollë që nuk dinë shkrim dhe lexim janë subjekt të cilët për nga numri janë më të mëdhenjë që të paraqiten si subjekt potencial për të kryer vepër penale e që tregohet qartë që arsimi ka ndikim të madhë në parandalimin e krimit në shoqëri.

- Të luftohet me të gjitha mjetet që të bëhet parandalimi i krimit dhe zvogëlimi i kriminalitetit
- Të ketë kushte të mirëfillta për personat të cilët gjenden në burg
- Të ketë hapësirë të nevojshme në burg që këta persona të mundet që nëpërmjet dënimit të arrijnë qëllimin e burgut e që është risocializimi
- Të i mundësohet personave të burgosur që të realizojnë aktivitete të ndryshme të tyre që do të jenë në dobi të tyre dhe shëndetit të tyre
- T'i jepet një rëndësi e veçantë arsimit dhe edukimit nga shkaku që sipas analizave e pamë që arsimi është njëra ndër faktorët kryesor që ndihmon në parandalimin ose zvogëlimin e krimit në shoqëri

Ky punim paraqet një reflektim të qartë se kryerësit e veprave penale duhet të ballafaqohen me sanksionin e veprimeve të veta, si pasojë që veprimi i tyre është i paraparë si vepër penale.

Kur flasim për pjesën e dënimit në rastin konkret flasim për mjete të atilla të cilat janë të detyrueshme që t'i jepen kryerësve të veprave penale, ngase me veprën penale që kryhet çënohet interesi kolektiv i shoqërisë. Në këtë rast e tërë shoqëria është në rrezik dhe për këtë arsye secili që kryen vepër penale do të duhet t'a ketë parasysh dënimi përkatës.

Kur kryhet një vepër penale nënkuptohet që në mënyrë direkte nuk është çënuar vetëm interesi ose ndonjë e drejtë e viktimës, por është çënuar interesi kolektiv i shoqërisë, për shkak se krimi është një defekt i cili duhet të luftohet me të gjitha mjetet e mundshme.

Pasi që subjekti shpallet si fajtor për veprën të cilën e ka kryer ai duhet që të mban sanksionin e që në rastin konkret flasim për dënimin me burg. Këtu është dhënë një pasqyrë e qartë e numrit të kryerësve të veprave penale për një periudhë kohore 5 vjeçare dhe kategorime të rëndësishme për të pasur parasysh rrethanat e caktuara të cilët kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale nga kryerësi.

Bibliografia

- Ligje, kode penale:

- Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.150/20106
- Ligji për procedurë penale 1997
- Службен весник на РМ, 2/06, 57/10, Закон за извршување на санкциите, Службен весник на РМ, 2/06, 57/10 – 2004
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Закон за Кривичната постапка, Службен весник на РМ бр. 150/2010, бр. 100/2012
- Закон за извршување на санкциите од 29.12.2005 година, измени и дополнувања, 2010/2014/2015. 2017 година
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Libra:

- Kambovski Vlado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2010
- Zejneli Ismail, Kambovski Vlado, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
- Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенологија, Второ Дополнето и Изменето издание, Скопје, 2005
- Проф. Д-р., Сулејманов, Зоран, Пенитенцијарни установи во Македонија, Скопје, 2003
- Dr. Ragip Halili, Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2009

- Penologjia, Ragip Halili, Prishtinë, 2014
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Tetovë, 2007
- Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale, Shkup, 2018
- Arnaudovski Lupço, Penologjia: nauka za izvrshvanje na krivicnite sankcii” Skopje 1998
- Matovski, Bikolla, Kazneno procesno parvo – opsht del” – Skopje 2003
- Kodi Penal i Repblikës së Maqedonisë, Afrim Osmani, Shkup 2017
- Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Afrim Osmani, Shkup 2013
- **Linqe nga interneti:**
- <https://www.stat.gov.mk/> - Државен завод за статистика – Enti shtetëror i statistikës
- <https://akademik.mk/>
- <http://www.pravo.org.mk/>
- <https://www.britannica.com>
- <https://pravdiko.mk>